



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.2030/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “B...” Komuna e Ferizajit, të cilën e përfaqëson J.B avokat nga Ferizaji, kundër debitorit N.P.T. “B...” , me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson B.S, avokat nga Ferizaji, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.40/2022 të datës 02.03.2022 të Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 23.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.T. “B...”, ANULOHET urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.40/2022 i datës 02.03.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr. 176/19 të datës 03.11.2021 ka nxjerr urdhrin P.nr.40/2022 me datën 02.03.2022, me të cilin është detyruar debitori N.P.T. “B...”, që të ia paguaj kreditorit shumën prej 1,830.00 € në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimin të urdhrin, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para ose me regjistrimin, konfiskimin, shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe nga shitja e mjeteve të realizohet borxhi i kreditorit gjegjësisht bartja e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se nuk qëndrojnë theksimet si në propozimin për përmbartim duke shtuar se debitori do të sjell prova dhe fakte që ky urdhër përmbartimor e vë në situatë të përmbartueshmërisë dhe se ky borxh nuk ka bazë juridike

pasi që vlera për shpenzimet procedurale për tri seanca gjyqësore është rreth 800 €, ndërsa gjykata ka vendosur kundërligjshëm vlerën e shpenzimeve procedurale dhe se në rastin konkret është përgatitur paraqitja e revizionit në Gjykatën Supreme, për çka ka shumë pritshmëri se vendimi i Gjykatës Supreme do të jetë në favor të debitorit dhe do të anulohen aktgjykimet e dy gjykatave. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit.

Përfaqësuesi i kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke shtuar se pretendimet e debitorit janë të karakterit kontestimor dhe debitori të njëjtat ka mundur ti paraqes në ankesën kundër aktgjykimin të shkallës së parë, ankesë e cila është refuzuar nga gjykata e apelit. Ka shtuar se debitori me asnjë fjalë të vetme nuk e ka dhënë ndonjë arsytim ligjor apo faktik se cila është arsyeja e mos pagesës së shumës që është objekt përmbarimi. Ka shtuar se kërkesa e kreditorit i plotëson kushtet ligjore dhe se qëllimi i debitorit është vetëm zvarritja e procedurës. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar, duke i kërkuar edhe shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit të dhëna në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Në rastin konkret rezulton se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike V. EK.nr.176/19, të datës 02.11.2021 i përmirësuar sipas aktvendimit V.Ek.nr 176/19 të datës 17.11.2021, me të cilin debitori është detyruar që kreditorit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore ti paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 1,830.00 €.

Gjykata gjeti se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbarimit, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 i cili

përcakton “*Organi përmbaues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbaues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” dhe nenit 36 par. 1 i cili përcakton se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbaues i dorëzohet edhe dokumenti përmbaues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbaueshmërisë për përmbaueshmëri*”, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti përmbarimor Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.176/19 i datës 02.11.2021 i përmirësuar sipas aktvendimit V.Ek.nr 176/19 të datës 17.11.2021, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbauesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbaueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarim të përcaktuara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, me çka rezulton se urdhri i lejuar nga ana e përmbauesit privat nuk i plotëson kushtet për përmbarim që duhet t’i ketë dokumenti përmbarimor, të parapara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është lëshuar urdhri nga përmbauesi privat duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2030/22, datë 23.11.2022

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve

nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.